



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07
Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 15 korrik 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për Riklasifikimet dhe Versionet e Redaktuara

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hysni Gucatit
Xhonatan Elistan Ris
Hju Bauden

Mbrojtësit të Nasim Haradinajt
Tobi Kadman
Karl Bakli

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE¹ në pajtim me nenet 21(2) dhe 39(6) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 82(5) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara (“Rregullorja”), nxjerr këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 10 qershor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi palët të dorëzonin parashtrime mbi riklasifikimin e parashtrimeve të protokolluara (“Urdhri”).²
2. Më 21 qershor 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) paraqiti parashtrime në përputhje me këtë Urdhër.³
3. Më 23 qershor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake informoi palët se kalimi i dosjes gjyqësore në pajtim me rregullën 98(3) të Rregullores është vendosur më 16 korrik 2021.⁴
4. Më 25 qershor 2021, Mbrojtja e z. Gucati (“z. Gucati”) paraqiti parashtrime në përputhje me këtë Urdhër.⁵

¹ KSC-BC-2020-07, F00061, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 29 tetor 2020, publik.

² KSC-BC-2020-07, F00225, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Parashtrime në lidhje me Riklasifikimin e Parashtrimeve të Protokolluara (“Urdhri”)*, 10 qershor 2021, publik.

³ KSC-BC-2020-07, F00240, Prokurori i Specializuar, *Parashtrimet e Prokurorisë në lidhje me Riklasifikimin e Parashtrimeve të Protokolluara*, 21 qershor 2021, publik.

⁴ KSC-BC-2020-07, F00244, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Dorëzimin e Aktakuzës së Korrigjuar dhe për një Kalendar të Dytë të Rishikuar për Pjesën e Mbetur të Procedurës Paraprake*, 23 qershor 2021, publik, para. 22(e).

⁵ KSC-BC-2020-07, F00247, Mbrojtja e z Gucati, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Urdhrit për Parashtrime në lidhje me Riklasifikimin e Parashtrimeve të Protokolluara*, 25 qershor 2021, publik.

5. Më 29 qershor 2021, ZPS-ja iu përgjigj parashtrimeve të Mbrojtjes së z. Gucati.⁶ Mbrojtja nuk u kundërpërgjigj.

6. Më 29 qershor 2021, katër ditë pas afatit të caktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Mbrojtja e Nasim Haradinajt ("z. Haradinaj") paraqiti parashtrime në përputhje me këtë Urdhër.⁷

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

7. Në bazë të neneve 21(2) dhe 39(6) të Ligjit, seancat janë publike, përveçse kur Gjykatësi përkatës vendos ndryshe në pajtim me Rregulloren.

8. Në pajtim me rregullën 82(5) të Rregullores, kur arsyet për riklasifikimin pushojnë së ekzistuari, dorëzuesi i parashtrimit të protokolluar të parë i paraqet kërkesë panelit për riklasifikim. Gjithashtu, paneli mund ta riklasifikojë statusin e një parashtrimi të protokolluar me kërkesë të një pjesëmarrësi tjetër në proces apo *proprio motu*.

III. DISKUTIMI

9. Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të nevojshme të rishikojë klasifikimin e disa parashtrimeve të protokolluara në dosjen e çështjes, në mënyrë që të respektohet parimi i procedurave publike, i cili vlen jo vetëm për seancat në sallën e gjyqit, por edhe për parashtrimet e protokolluara dhe çdo material tjetër në dosjen e çështjes. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton interpretimin e këtyre dispozitave të parashtruara me hollësi më parë.⁸

⁶ KSC-BC-2020-07, F00248, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Mbrojtjes në lidhje me Riklasifikimin e Parashtrimeve të Protokolluara*, 29 qershor 2021, publik.

⁷ KSC-BC-2020-07, F00249, Mbrojtja e z. Haradinaj, *Parashtrime të Mbrojtjes së z. Haradinaj në lidhje me Riklasifikimin e Parashtrimeve të Protokolluara*, 25 qershor 2021, publik.

⁸ Urdhri, para. 9-10.

10. Në pajtim me nenet 23 dhe 62 të Ligjit, rregullën 80 të Rregullores dhe nenin 33 të Udhëzuesit të Punës për Dosjet e Parashtrimet e Protokolluara, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u kujton palëve që në versionet e redaktuara publike të parashtrimeve të protokolluara duhet të hiqet çdo informacion që zbulon: (i) emrin, identitetin ose të dhënat e tjera personale të dëshmitarëve (të mundshëm), të personave të tjerë, përfshirë zyrtarët shtetërorë, që ndërveprojnë me ZPS-në si dhe me punonjësit e ZPS-së; (ii) organizatat shtetërore dhe ndërkombëtare ose subjektet bashkëpunuese me ZPS-në për hetimet e saj; (iii) dokumente ose pjesë të tyre që i janë dhënë Mbrojtjes në mënyrë konfidenciale; dhe (iv) përmbajtjen e çdo dokumenti tjetër konfidencial sipas urdhrave të Dhomave të Specializuara.

11. Pasi shqyrtoi parashtrimet e lartpërmendura të palëve dhe treguesit konfidencialë në parashtrime të tjera të bëra nga palët, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron Zyrën Administrative të riklasifikojë parashtrimet e mëposhtme si **publike**:

- F00046, 14 tetor 2020;
- F00049, 14 tetor 2020;
- F00180, 9 prill 2021;
- F00185, 20 prill 2021;
- F00198, 9 maj 2021;
- F00200, 11 maj 2021;
- F00202, 17 maj 2021;
- F00211, 26 maj 2021;
- F00216, 3 qershor 2021;
- F00217, 3 qershor 2021;
- F00218, 3 qershor 2021;
- F00219, 3 qershor 2021;
- F00220, 7 qershor 2021;

- F00221, 7 qershor 2021;
- F00223, 8 qershor 2021;
- F00226, 10 qershor 2021;
- F00227, 10 qershor 2021;
- F00230, 14 qershor 2021;
- F00231, 14 qershor 2021;
- F00233, 14 qershor 2021;
- F00234, 14 qershor 2021;
- F00235, 15 qershor 2021;
- F00236, 15 qershor 2021;
- F00237, 15 qershor 2021;
- F00239, 17 qershor 2021;
- F00253, 6 korrik 2021;
- F00257, 9 korrik 2021.⁹

12. Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron më tej ZPS-në që të parashtrojë versionet publike të redaktuara të parashtrimeve konfidenciale në vijim ose të tregojë nëse mund të riklasifikohen si publike:

- F00107, 29 janar 2021;
- F00110, 1 shkurt 2021;
- F00118, 9 shkurt 2021;
- F00127, 16 shkurt 2021;
- F00130, 19 shkurt 2021;
- F00149, 8 mars 2021;
- F00164, 26 mars 2021;

⁹Data e shënuar në listën e mësipërme është data e parashtrimeve, siç paraqitet në Legal Workflow.

- F00181/A01, 9 prill 2021;
- F00252, 5 korrik 2021.¹⁰

13. Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron më tej Mbrojtjen e z. Gucati që të parashtrojë versionet publike të redaktuara të parashtrimeve konfidenciale në vijim ose të tregojë nëse mund të riklasifikohen si publike:

- F00119, 10 shkurt 2021;
- F00122, 11 shkurt 2021;
- F00157, 18 mars 2021;
- F00255, 8 korrik 2021;
- F00258, 12 korrik 2021.¹¹

14. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron Mbrojtjen e z. Gucati të dorëzojë një version publik të redaktuar të F00199, duke zbatuar redaktimet e propozuara nga ZPS-ja në F00248, Shtojca 1.

15. Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron më tej Mbrojtjen e z. Haradinaj që të parashtrojë versionet publike të redaktuara të parashtrimeve konfidenciale në vijim ose të tregojë nëse mund të riklasifikohen si publike:

- F00123, 12 shkurt 2021;
- F00256, 8 korrik 2021;
- F00260, 12 korrik 2021.¹²

16. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se shtojcat mbulohen nga urdhrat e mësipërm vetëm kur ato përmenden shprehimisht.

¹⁰Data e shënuar në listën e mësipërme është data e parashtrimeve, siç paraqitet në Legal Workflow.

¹¹Data e shënuar në listën e mësipërme është data e parashtrimeve, siç paraqitet në Legal Workflow.

¹²Data e shënuar në listën e mësipërme është data e parashtrimeve, siç paraqitet në Legal Workflow.

IV. VENDIM

17. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **URDHËRON** Zyrën Administrative të riklasifikojë si publike parashtrimet e përmendura në paragrafin 11, deri të **mërkurën, 21 korrik 2021;**
- b. **URDHËRON** ZPS-në të paraqesë versione publike të redaktuara ose të kërkojë riklasifikimin si publike të parashtrimeve të përmendura në paragrafin 12, deri të **premtën, 27 gusht 2021;**
- c. **URDHËRON** Mbrojtjen e z. Gucati të paraqesë versione publike të redaktuara ose të kërkojë riklasifikimin si publike të parashtrimeve të përmendura në paragrafin 13, deri të **premtën, 3 shtator 2021;**
- d. **URDHËRON** Mbrojtjen e z. Gucati të paraqesë një version publik të redaktuar të F00199 siç përcaktohet në paragrafin 14, deri të **premtën, 3 shtator 2021;** dhe
- e. **URDHËRON** Mbrojtjen e z. Haradinaj të paraqesë versione publike të redaktuara ose të kërkojë riklasifikimin si publike të parashtrimeve të përmendura në paragrafin 15, deri të **premtën, 3 shtator 2021.**

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E enjte, 15 korrik 2021

Hagë, Holandë.